



PËRMBLEDHJE STUDIMORE E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË FALIMENTIMIT TË REGJISTRUARA SIPAS LIGJIT TË RI TË FALIMENTIMIT



Në partneritet me:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Confederation

Federal Departement of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Përmbajtja

Pjesa 1 - Hyrje.....	7
Pjesa 2 - Metodologjia dhe Vështirësitë e hasura.....	9
Pjesa 3 - Çështjet konkrete.....	12
3.1. Çështjet që nuk përfshihen në objektin e zbatimit të LF-së.....	12
3.2. Rrëzime dhe përsëritje e çështjeve të ngjashme	14
3.3. Çështje me mungesë pasurie.....	21
3.4. Çështje e përfunduar me finalizimin e procedurës së falimentimit.....	29
Pjesa 4 - Disa reflektime në formën e komenteve të autorëve në lidhje me rastet e studiuara në Pjesën III	31
SHTOJCA A Statistikat e Çështjeve.....	33

© Korporata Ndërkombëtare Financiare 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

2121 Pennsylvania Avenue, N.W.
Washington, D.C. 20433 Internet: www.ifc.org

Materiali mbrohet nga e drejta e autorit. Kopjimi dhe/ose transmetimi i pjesëve ose i gjithë këtij materiali pa leje mund të përbëjë shkelje të ligjit në fuqi. IFC nuk garanton saktësinë, besueshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së përfshirë në këtë material, ose për përfundimet ose gjykimet e përshkruara këtu, dhe nuk mban asnjë përgjegjësi për ndonjë lëshim ose gabim (përfshirë, pa kufizim, gabime tipografike dhe teknike) në çfarëdo përmbajtjeje ose për mbështetje në të.

Rreth IFC-së

IFC, një anëtare e Grupit të Bankës Botërore, është institucioni më i madh global i zhvillimit i përqendruar në sektorin privat në tregjet në zhvillim. Ne punojmë në më shumë se 100 vende, duke përdorur kapitalin, ekspertizën dhe ndikimin tonë për të krijuar tregje dhe mundësi në vendet në zhvillim. Në vitin fiskal 2021, ne kemi investuar një shumë rekord prej 31.5 miliardë dollarë në shoqëri private dhe institucione financiare në vendet në zhvillim, duke shfrytëzuar fuqinë e sektorit privat për t'i dhënë fund varfërisë ekstreme dhe për të rritur prosperitetin e përbashkët ndërsa ekonomitë përballen me ndikimet e pandemisë COVID-19. Për më shumë informacion, vizitoni www.ifc.org.

RRETH AUTORËVE

KALO & ASSOCIATES (themeluar më 1994) është një zyrë ligjore e cila ofron shërbime ligjore në të gjitha aspektet e ligjit tregtar në Shqipëri dhe Kosovë, duke përfaqësuar shoqëri dhe agjenci të shquara, të huaja dhe ndërkombëtare, përfshirë disa Fortune 500, që bëjnë biznes në një spektër të gjerë të industrive në të gjithë globin, përfshirë rajonin e Ballkanit. Zyra punëson avokatë të kualifikuar dhe të përkushtuar me përvojë të konsiderueshme në trajtimin e çështjeve ligjore të sofistikuar dhe komplekse dhe transaksione sipas standardeve ndërkombëtare, në mjedisin lokal. Zyra administron me sukses dhe në kohën e duhur çështje tregtare për shkak të departamenteve të strukturuar: 1) Shoqëritë tregtare (M&A dhe JV), 2) Shërbime bankare dhe financiare, 3) Projektet (koncesione dhe PPP) në fushat e energjisë & burimeve natyrore, 4) Pronësia intelektuale (përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale, etiketimin, shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale), 5) Punësimi & migracioni, dhe 6) Përfaqësimi në gjykatë, ndërmjetësimi dhe arbitrazhi. KALO & ASSOCIATES gëzon njohjen rajonale duke qenë një anëtar themelues i SEE LEGAL (South East European Legal Group), grupi drejtues rajonal i 10 zyrave ligjore, të cilat ofrojnë shërbime ligjore cilësore, duke përfshirë transaksione tregtare ndërkufitare në 12 juridiksione të SEE LEGAL që prej 2003.

ANDRÉS F. MARTÍNEZ është Specialist i Lartë në Sektorin Financiar në fushën e Falimentit dhe Zgjidhjes së Borxhit, pjesë e Praktikës Globale të Grupit të Bankës Botërore për Financat, Konkureshmërinë dhe Inovacionin. Andrés është diplomuar në fushën e të drejtës në vitin 2000 dhe ka praktikuar ligjin e falimentit në një kompani të madhe ligjore në Argjentinë, që kur u pranua në dhomën e avokatëve (2001) deri në 2008, kur u bashkua me Grupin e Bankës Botërore. Ai ka drejtuar treguesin e "paaftësisë paguese" të "Doing Business" (të Bërit Biznes) të Grupit të Bankës Botërore deri në 2011 dhe që atëherë ka ofruar konsulencë në disa vende në lidhje me reformën në fushën e falimentit dhe zgjidhjes së borxhit, në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, Amerikën Latine, Azinë Lindore dhe Lindjen e Mesme. Në pozicionin e tij aktual, ai drejton dialogun me disa qeveri në lidhje me çështje teknike në fushën e zgjidhjes së borxhit dhe paaftësisë paguese.

SERGIO A. MURO punon si Konsulent në fushën e Falimentit dhe Zgjidhjes së Borxhit (me fokus tek falimenti dhe zbatimi i kontratës), pjesë e Praktikës Globale të Grupit të Bankës Botërore për Financat, Konkureshmërinë dhe Inovacionin. Që në 2016, ai ka ofruar konsulencë vendeve të ndryshme mbi reformën për zgjidhjen e borxhit, duke përfshirë sistemet e falimentit dhe rekuperimin e borxhit në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, Azinë Lindore, dhe Lindjen e Mesme. Përveç kësaj, ai drejton Projektin e Gjykatës së Lartë Argjentinase në Universidad Torcuato Di Tella, ku ai studion mënyrën si merren vendimet e Gjykatës së Lartë.

PROJEKTI DHE PËRBËRJA E GRUPIT

Menaxheri i Projektit | Igor Matijevic, është një Specialist i Lartë i Sektorit Financiar në Departamentin e Këshillimit për Krijimin e Tregjeve pranë Grupit të Bankës Botërore (IFC/ WBG), me eksperiencë prej 15 vitesh në këtë organizatë ndërkombëtare në disa shtete të Evropës dhe Azisë Qendrore (ECA) me fokus kryesisht në Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, ai është Menaxher Rajonal i Projektit Zgjidhja e Borxhit dhe Dalja e Biznesit në Ballkanin Perëndimor, në kuadër të së cilit organizon dhe lehtëson zbatimin e tij në pesë shtete (Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Maqedonia e Veriut dhe Serbi) nëpërmjet komunikimit dhe koordinimit me klientët qeveritar, agjencitë dhe institucionet, si dhe rrjetit të gjërë të palëve të interesit ndërkombëtar dhe lokal. Z. Matijevic zotëron dije të thella dhe eksperiencë në legjislativonin dhe zbatimin e zgjidhjes së borxhit, shoqëruar me një mirëkuptim të fortë në mundësimin e biznesit dhe në reformat e sektorit financiar.

Koordinatorja e Projektit | Irena Gribizi, i është bashkuar IFC-së që në vitin 2001 dhe ka punuar si Drejtuese Operacionale për menaxhimin e disa projekteve në Shqipëri me fokus zhvillimin e sektorit privat. Nga viti 2012 znj. Gribizi, Profesioneiste e Certifikuar në Menaxhimin e Projektit (PMP) është angazhuar si konsulente për IFC-në/Grupin e Bankës Botërore dhe në cilësinë e koordinatorës për Shqipërinë ka drejtuar projektet për përmirësimin e klimës ku operon biznesi, ku mund të përmendim: Thjeshtësimi i Taksave dhe Transferimi i Çmimit, Logjistika Tregtare në Ballkanin Perëndimor, Klima e Investimeve dhe Konkurrueshmëria në Agrobiznes, Mbështetja për Lehtësimin e Tregtisë dhe Zgjidhja e Borxhit dhe Dalja nga Biznesi. Si pjesë e projektit të fundit, ajo ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në negociatat me klientët qeveritarë, në hartimet e propozimeve për projektin, në koordinimet e aktiviteteve në vend dhe në menaxhimin e gjithë ekipit lokal dhe të huaj për projektin. Znj. Gribizi ka mbështetur projektin veçanërisht në disa seminare të nivelit të lartë me zyrtarë të qeverisë, sikurse ka drejtuar me sukses procesin e hartimit të ligjit të ri për falimentin në Shqipëri.

Nën mbikqyrjen e: Damien Shiels, Menaxher i Praktikës (IFC AS), në Evropën Lindore & Azinë Qendrore, Praktika Globale për Financat, Konkurrueshmërinë dhe Inovacionin dhe Mahesh Uttamchandani, Menaxher i Praktikës, EFNFI, Praktika Globale për Financat, Konkurrueshmërinë dhe Inovacionin.

1 Hyrje

Në kuadër të Fazës II të Projektit të Zgjidhjes së Borxhit, Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), anëtare e Grupit të Bankës Botërore (WBG), me mbështetjen e Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), kërkoi përgatitjen e një përmbledhje të praktikës gjyqësore ("Praktika Gjyqësore^[1]") për çështjet e falimentimit në Shqipëri të depozituara në bazë të ligjit të ri nr. 110/2016 "Për falimentimin" ("LF-ja"), për t'u përdorur kryesisht nga administratorët dhe gjyqtarët e falimentimit.

U kërkua që praktika gjyqësore të analizonte dhe sqaronte çështjet e para konkrete të shqyrtuara dhe të përfunduara nga gjykatat shqiptare, duke qenë se tashmë LF-ja ka më shumë se katër vjet që ka hyrë dhe është në fuqi, me vendime gjyqësore që kanë filluar të shpallen. Rehabilitimi i debitorëve në vështirësi financiare dhe shpëtimi i bizneseve të ngarkuara me borxhe, janë bërë tema kryesore në administrimin dhe riorganizimin e çështjeve të falimentimit. LF-ja u hartua për të ofruar një sistem më të parashikueshëm që krijon një ekuilibër më të mirë midis të drejtave të debitorëve dhe të kreditorëve gjatë procedurave gjyqësore. Për këtë qëllim, kryerja e një studimi të praktikave më të mira deri më tani ishte shumë e rëndësishme për të identifikuar nëse qëllimet e LF-së po zbatohen në mënyrë korrekte.

Përmbajtja e kësaj praktike gjyqësore fokusohet në identifikimin, studimin dhe publikimin e praktikave të para dhe çështjeve reale të depozituara në gjykatat shqiptare sipas LF-së. Qëllimi i këtij dokumenti është të shërbejë si një burim unik referimi për gjyqtarët shqiptarë, administratorët e falimentimit dhe të gjithë praktikuesit që dëshirojnë të studiojnë natyrën dhe procesin e çështjeve të falimentimit në Shqipëri sipas regjimit të LF-së.

Shpjegimet e dhëna për rastet studimore mund të lehtësojnë zhvillimin e kapaciteteve për të gjitha palët në një proces falimentimi, nëpërmjet një përshkrimi gjithëpërfshirës dhe praktik të çështjeve më të spikatura në Shqipëri. Ky dokument përshkruan problematikat ligjore të çdo rasti dhe procedurën e ndjekur të parë nga dy këndvështrime të ndryshme: (i) procedura e ndjekur nga gjykatat dhe zgjidhjet përkatëse ligjore dhe (ii) roli i administratorëve të falimentimit kur dhe nëse caktohen nga gjykatat.

Aktualisht të gjitha çështjet e falimentimit në Shqipëri drejtohen nga gjykatat e rretheve nëpërmjet seksionit të tyre tregtar. Fluksi i çështjeve ndryshon shumë nga gjykata në gjykatë bazuar në vendndodhjen e tyre dhe zhvillimin ekonomik të rrethit që ka nën juridiksion gjykata përkatëse. Pavarësisht përmirësimeve të sjella nga LF-ja dhe

[1] Përmbledhja e praktikës gjyqësore është përgatitur nga zyra shqiptare e avokatisë KALO & ASSOCIATES ("autorët") dhe përmban të dhëna gjithëpërfshirëse nga ekspertët e falimentimit të Bankës Botërore / IFC, Andres F. Martinez (Specialist i Lartë i Sektorit Financiar, Financën, Konkurrueshmërinë dhe Inovacionin) dhe Sergio Muro (Konsulent i Lartë Ndërkombëtar për Financën, Konkurrueshmërinë dhe Inovacionin).

përfshirjes së mekanizmave të reja, puna përgatitore për këtë praktikë gjyqësore tregoi se një numër i kufizuar i çështjeve të falimentimit janë depozituar në bazë të LF-së. Për më tepër, kjo tregon se kërkesat për fillimin e procedurave të falimentimit nuk janë kuptuar gjithmonë siç duhet nga palët, siç vihet re nga rrëzimi i vazhdueshëm i kërkesave të ngritura nga gjyqtarët shqiptarë.

Në kufizimin e informacionit që autorët mund të mblidhnin për secilën çështje kanë kontribuar dy faktorë kryesorë, konkretisht (1) kufizimet e vendosura nga kuadri ligjor shqiptar për informacionin që konsiderohet konfidencial për palët si pjesë e procedurave të falimentimit dhe (2) kufizimi që lind për shkak të përpunimit të informacionit nga gjykatat e përfshira në çdo dosje gjyqësore.

Ky dokument është i strukturuar si më poshtë. Pjesa II përshkruan metodologjinë e përdorur në përjasjen ndaj praktikave gjyqësore dhe sfidat në përgatitjen e dokumentit. Pjesa III fokusohet në analizën e çështjeve duke shqyrtuar çështjet reale të përzgjedhura. Pjesa IV ofron disa udhëzime në formën e komenteve të autorëve në lidhje me çështjet e studiara në Pjesën III, dhe së fundi, një shtojcë që përmban statistika për çështjet e paraqitura i bashkëngjitet këtij dokumenti mbi praktikën gjyqësore.

2 Metodologjia dhe Vështirësitë e hasura

Kjo Përmbledhje përdor një strategji kërkimore sasiore, ndërkohë që metoda kërkimore e zbatuar ka qenë ajo e interpretimit. Kjo do të thotë se lidhja midis variablave të ndryshëm duhej të vendosej përmes interpretimit. Për qëllimet e kësaj Përmbledhje, u krye një punë e konsiderueshme dhe e detajuar parapërgatitore, bashkë me intervista me nëpunës të gjykatave të rrethit.

Puna u krye në formën e një kërkimi të detajuar të të dhënave dhe informacionit të mbajtur nga Gjykatat Shqiptare në arkivat e tyre fizike dhe elektronike.

Në kuadër të depozitimit dhe përzgjedhjes së çështjeve më të spikatura për praktikën gjyqësore, u krye një procedurë e plotë e komunikimit dhe mbledhjes së të dhënave^[2] me shtatë gjykatat kryesore të falimentimit në rrethet e Shqipërisë, përkatësisht Gjykatat e Rretheve Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Fier dhe Korçë. Këto gjykata të rretheve konsiderohen si më kryesoret në Shqipëri duke pasur parasysh dendësinë e popullsisë dhe gjithashtu aktivitetin ekonomik në çdo qytet. Gjithashtu, gjykatat e përzgjedhura mbulojnë në mënyrë kumulative më shumë se 80% të territorit shqiptar dhe janë gjithashtu gjykatat kryesore që kanë krijuar seksione për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve tregtare (dhe rrjedhimisht të falimentimit). Nisur nga faktorë të tillë, këto gjykata janë ato që marrin volumn më të madh të çështjeve të falimentimit në vend.

Procesi i mbledhjes së të dhënave filloi përmes një kërkesë fillestare për mbledhjen e të gjitha të dhënave të mundshme në lidhje me çështjet e depozituara në bazë të LF-së së ri deri në dhjetor 2021. Të gjitha gjykatave të përzgjedhura iu dërguan letra duke kërkuar identifikimin e numrit të çështjeve të depozituara, vendimet e marra nga gjykatat përkatëse dhe mënyrën e marrjes së këtyre vendimeve. Më pas, çdo gjykatë u kontaktua në mënyrë të rregullt përmes telefonit dhe u kërkuan takime me sekretariatet e gjykatës që ishin personat/strukturat përgjegjëse për bazat e të dhënave dhe arkivin e gjykatës. Pas një pune paraprake të bërë pikërisht nga sekretariatet, ekspertëve iu kërkua të paraqiteshin personalisht në gjykata për të parë të dhënat e disponueshme dhe për të ndihmuar më tej sekretariatet për çdo kërkim shtesë. Për këtë arsye, eksperti ekzaminoi në vend të gjitha dokumentet e paraqitura dhe kërkoi informacione të mëtejshme duke iu shpjeguar në detaje sekretariateve se çfarë mungonte në bazë të rezultatit të parashikuar nga kërkimi.

[2] Që nga dhjetori 2021, informacioni i dhënë për rastet e falimentimit në Shqipëri është i kufizuar në statistikat e shfaqura në faqet e internetit të Gjykatave Rajonale. Këto të dhëna janë gjithashtu të kufizuara vetëm në informacionin bazë si (1) numri i çështjeve të paraqitura në vit, (2) numri i çështjeve në proces, (3) numri i çështjeve të bartura nga viti i kaluar dhe (4) numri i çështjeve të përjashtuara. Në këtë aspekt, IFC-ja së bashku me KALO & ASSOCIATES në dhjetor të vitit 2021 paraqitën një kërkesë zyrtare në 7 gjykatat rajonale të synuara për të ofruar informacion mbi rastet e falimentimit, të cilat tani janë pjesë përbërëse e kësaj përmbledhje e praktikës gjyqësore.

Vështirësitë e hasura

Disa gjykata, si ajo e Elbasanit, Korçës dhe Vlorës, kanë dhënë vetëm informacion statistikor në lidhje me numrin e çështjeve të falimentimit të regjistruara në këto gjykata. Prandaj, nuk kemi mundur të shqyrtojmë rrethanat e tjera të çështjeve të regjistruara, apo vendimeve të marra nga gjykatat e përmendura. Si rrjedhojë, u mor vendimi për të shfaqur vetëm informacionin e mbledhur nga çështjet e gjykuara nga gjykatat e Tiranës, Durrësit, Fierit dhe Shkodrës.

Përzgjedhja e çështjeve

Çështjet në vetvete duhet të konsiderohen si fokusi kryesor i kësaj pune dhe si rrjedhojë kujdes i veçantë i është kushtuar procesit të përzgjedhjes pas marrjes së të gjitha dosjeve nga sekretariatet e gjykatave. Çështjet u zgjodhën nga një grup i kufizuar duke pasur parasysh numrin e ulët të kërkesave të paraqitura sipas LF-së^[3]. Fokusi i kërkimit dhe përzgjedhjes ishte identifikimi i problemeve kryesore si koordinimi i pretendimeve të kreditorëve, roli i administratorit të falimentimit dhe vendosja e një plani riorganizimi ndër të tjera. Përveç fokusit kryesor të përmendur, metoda e përzgjedhjes për këtë përmbledhje ishte vendosur edhe në publicitetin dhe karakteristikën e çështjes, duke marrë parasysh popullaritetin e kreditorëve ose debitorëve. Në lidhje me karakteristikat e çështjeve, fokusi ynë ishte të identifikonim të paktën një rast për secilin nga komponentët e mëposhtëm të LF-së: kërkesë për falimentim e paraqitur nga kreditori, kërkesë për falimentim e paraqitur nga debitori, mbyllja e procedurave për shkak të mungesës së pasurive për të mbështetur procedurën e falimentimit, çështjet e pushuara me riorganizimin e debitorit, çështjet e pushuara me likuidimin e debitorit, 2 çështjet që përmbanin vendime të ndërmjetme të gjykatës, çështjet e pushuara nga gjykatat për mungesë dokumentacioni dhe çështjet në të cilat ishte i dukshëm roli i administratorit. Natyrisht, duke pasur parasysh numrin e ulët të çështjeve të regjistruara, nuk ishte e mundur të identifikohesh të paktën një rast për secilin komponent, por për qëllime të ofrimit të një përmbledhje gjithëpërfshirëse për lexuesin, autorët u përpoqën të përfshinin gamën më të gjerë të mundshme të çështjeve duke shmangur përsëritjen e çështjeve të njëjta më shumë se një herë.

Seksioni III më poshtë shpjegon saktësisht se çfarë nxori në pah procesi i përzgjedhjes së çështjeve dhe çfarë mbulon kjo përmbledhje për sa i përket numrit dhe gamës së çështjeve të përzgjedhura.

Çdo çështje e përzgjedhur përshkruhet duke ofruar një përmbledhje ligjore të vendimit të formës së prerë të gjykatës, duke e paraqitur atë në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme që përmban si interpretimin e gjykatës ashtu edhe bazën ligjore të marrë parasysh në marrjen e vendimeve.

Ashtu si në praktika të tjera të ngjashme, emrat e gjyqtarëve, palëve dhe gjithashtu shumat sensitive monetare janë fshehur për shkak të kërkesave të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave.

[3] Gjithsej 20 kërkesa janë depozituar në gjykata të ndryshme rajonale, por në një rast kreditori e ka tërhequr kërkesën.

3 Çështjet konkrete

Me qëllim përgatitjen e kësaj përmbledhje të praktikave gjyqësore, autorët shqyrtuan të gjitha vendimet gjyqësore duke kryer një analizë të detajuar të çështjeve të ndryshme. Analiza eidentoi veçori dhe të përbashkëta në vendimet e gjykatave, të lidhura më së shumti me faktin se nga 19 vendimet e marra, 16 prej tyre ishin vendime për pushimin ose rrëzimin e kërkesave për arsye të ndryshme procedurale, duke përfshirë por pa u kufizuar në mungesën ose dokumentet e pamjaftueshme të ofruara nga debitori ose kreditori gjatë paraqitjes së kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit^[4].

Çështjet të cilat nuk ishin finalizuar me rrëzimin e kërkesës përbëhen nga (3) tre vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Durrës dhe Fier. Në dy nga këto raste, debitori u shpall përfundimisht i falimentuar, ndërsa në rastin tjetër, autorët besojnë se vendimi përmbante një arsyetim disi të kufizuar që i pengonte ata të kuptonin plotësisht dhe tërësisht arsyetimin pas tij.

Çështjet e mëposhtme janë paraqitur në formën e ekstrakteve të vendimeve të formës së prerë të gjykatave të plotësuara edhe me elementë shtesë si historia e procesit (arsyeja e paraqitjes së kërkesës dhe informacioni historik për palët dhe vetë çështjen), procedurat e ndjekura, baza ligjore dhe arsyetimi i gjykatës për marrjen e vendimeve përkatëse.

Duke marrë parasysh natyrën e çështjeve, domethënë të përbashkëtat dhe veçoritë e tyre, dhe arsyetimet përkatëse të dhëna nga gjykatat në vendimet e tyre, autorët i kanë mbledhur dhe renditur çështjet në bazë të temave dhe çështjeve të tyre të përbashkëta.

3.1. Çështjet që nuk përfshihen në objektin e zbatimit të LF-së

Çështja	Rrëzimi i padisë pasi paditësi përjashtohet nga regjimi i përgjithshëm i falimentimit
Gjykata	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Seksioni Tregtar)
Data e vendimit	30 qershor 2021
Objekti	Kërkesë për hapjen e procesit të falimentimit me anë të likuidimit të një Agjencie qeveritare
Paditës	Një ministri si anëtare e vetme e një Agjencie qeveritare
Baza ligjore e shqyrtuar nga Gjykata për marrjen e vendimit	Neni 7 i LF-së

[4] Siç është vënë në dukje tashmë, në "Studimin pilot të Çështjeve të falimentimit të kërkuara nga debitori" të përgatitur nga ekspertët në vitin 2020, në justifikimin e rrëzimit të kërkesave dhe efekteve të tyre, gjykata dukej se po bënte referenca të përpikta në Kodin e Procedurës Civile (KPC) dhe referenca të kufizuara në LF.

Përmbledhje e çështjes

Abstrakt

Një nga ministritë shqiptare i bëri kërkesë gjykatës së falimentimit me qëllim prishjen e një Agjencie vartëse (të organizuar si organizatë jofitimprurëse). Agjencia në fjalë është themeluar nga qeveria për të promovuar dhe zbatuar një program për zhvillimin ekonomik të zonave të caktuara të vendit përmes mbështetjes financiare, teknike dhe iniciativave për ngritjen e kapaciteteve për bizneset vendase dhe sipërmarrjet turistike. Meqenëse programi arriti objektivat dhe afatet e përcaktuara dhe fondet ishin përdorur, qeveria përmes Ministrisë përkatëse vendosi të prishë Agjencinë përmes një procedure falimentimi me qëllim likuidimin e saj.

Detaje të procesit

Në seancën paraprake Ministria shpjegoi se, në zbatim të ligjit 9788/2001 "Për organizatat jofitimprurëse", Agjencia, duke qenë një organizatë jofitimprurëse, mund të prishet edhe nëse është në gjendje të paaftësisë paguese siç rregullohet nga legjislacioni përkatës i falimentimit. Në një kontekst të tillë, Ministria njoftoi gjykatën se duhet të caktohet një likuidues për prishjen e Agjencisë sipas rregullores së procedurës të ligjit 9788/2001. Më saktësisht, neni 46 i ligjit 9788/2001 parashikon se: kur prishja vendoset nga vetë organizata jofitimprurëse, likuidimi kryhet nga një ose disa likuidues të caktuar sipas statutit dhe gjithmonë përpara çregjistrimit nga gjykata. Kur gjykata vendos prishjen, ajo cakton edhe likuiduesin, duke i dhënë atij kompetencat e nevojshme për zhvillimin e procedurës së likuidimit. Gjithashtu, në bazë të nenit 19 të LF-së, Gjykata thërret një ekspert ose një administrator të përkohshëm (në cilësinë e ekspertit) i cili do të japë një mendim për fillimin ose jo të procedurës së falimentimit, ose më saktë për gjendjen e paaftësisë paguese, duke qenë se fjala "falimentim" në LF do të thotë gjendje paaftësie paguese. Në rast se administratori i përkohshëm deklaron se ka vërtet gjendje paaftësie paguese, gjykata mund të vendosë prishjen e organizatës jofitimprurëse.

Pasi dëgjoi argumentet e Ministrisë, Gjykata argumentoi se kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit të Agjencisë është e paargumentuar dhe e pabazuar në ligj, duke konsideruar se Agjencia bën pjesë në kategoritë e renditura në nenin 7 të LF-së. Vendimi i gjykatës lexon si më poshtë:

Pika 4 e nenit 7 të LF-së përcakton se ky ligj nuk zbatohet për shoqëritë e sigurimit, bankat, fondet e pensioneve, letrat me vlerë të fondeve të investimeve dhe institucionet e tjera që mbledhin depozita nga publiku ose institucionet e tjera financiare, për të cilat procedura e falimentimit rregullohet me ligjet e tyre të veçanta. Gjithashtu pika 5 e po këtij neni 7, përcakton se: "Në rast të paaftësisë paguese të një subjekti që ushtron veprimtarinë e tij në një sektor strategjik të përcaktuar me ligj

të posaçëm, si dhe të një subjekti që kryen një shërbim publik, zbatohet ky ligj nëse nuk rregullohet me një ligj të posaçëm, ose kur rregullohet me një të tillë, por subjektit i është hequr licenca.”.

Në këtë rast, vetë Agjencia ofron një shërbim publik pasi ofron mbështetje financiare dhe grante për subjekte të ndryshme në zonat e dedikuara. Duke qenë se është edhe një organizatë jofitimprurëse, atëherë kjo situatë duhet t'i referohet ligjit të posaçëm që është ligji 8788/2001.

Për rrjedhojë, kjo Agjenci, e përjashtuar nga zbatimi i LF-së, orientohet nga gjykata, të zbatojë dispozitat e ligjit 8788/2001, në veçanti nenet 44 dhe 46 të tij^[5].

Në rastin konkret, Gjykata, sipas pikave 4 dhe 5 të neneve 7 dhe 9^[6] të LF-së; dhe neneve 158/a/c/, dhe 299/c të KPC-së (nenet që rregullojnë çështjet në të cilat pretendimet nuk mund të paraqiten në Gjykatë), arrin në përfundimin se pretendimi duhet të rrëzohet, duke konsideruar se një pretendim i tillë nuk duhet të ishte paraqitur në Gjykatën e falimentimit.

3.2. Rrëzime dhe përsëritje e çështjeve të ngjashme

Çështja nr. 1 – Refuzimi i kërkesës për hapjen e procedurës së riorganizimit duke konsideruar se debitori nuk ishte në gjendje paaftësie paguese

Gjykata	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (Seksioni Tregtar)
Data e vendimit	26 shtator 2019
Objekti	Kërkesë për hapjen e procesit të riorganizimit të debitorit nëpërmjet miratimit të një plani riorganizimi në përputhje me LF-në
Paditësi	Debitori
Baza ligjore e shqyrtuar nga Gjykata për marrjen e vendimit	Nenet 2, 13, 14, 15, 17 dhe 22, 60, 82, 98 të LF-së

Përmbledhje e çështjes

Abstrakt

Debitori, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e përfshirë në biznesin e hotelerisë dhe turizmit kishte marrë një kredi të madhe nga një bankë shqiptare e nivelit të dytë me qëllim ndërtimin e një kompleksi ndërtesash për t'ia shitur më tej palëve të

[5] Ky nen rregullon caktimin e likuidatorit dhe procedurën e likuidimit të një organizatë jofitimprurëse.

[6] Juridiksioni i gjykatës së falimentimit

treta (blerësve). Megjithatë, pas përfundimit të ndërtimit, debitori hasi një vështirësi serioze në shitjen e njësive të ndërtesës pasi blerësit kërkuar ulje në çmimin e blerjes.

Duke qenë se procedurat e shitjeve të parashikuara të kompleksit ranë në mënyrë drastike, shoqëria filloi të kishte vështirësi në shlyerjen e kredisë, duke mos paguar disa këste radhazi. Kjo bëri që banka të nisë menjëherë procesin e ekzekutimit të shlyerjes së detyrimeve nëpërmjet zyrës së përmbarimit.

Detajet e procesit

Debitori pretendonte se ishte në gjendje paaftësie paguese sipas përkufizimit të paaftësisë paguese në LF, pasi pasuritë e tij dhe biznesi në përgjithësi po përballëshin me një rrezik real dhe konkret që buronte nga urdhrat e ekzekutimit të lëshuar nga Gjykata për përmbarimin e detyrimeve të papaguara të debitorit ndaj bankës së nivelit të dytë për marrëveshjen e kredisë të dhënë nga kjo e fundit. Sipas debitorit, kjo situatë e detyronte atë të riorganizonte biznesin me qëllim shlyerjen e kredisë së mbetur ndaj bankës. Ky argument shërben si një arsye që vërteton paaftësinë paguese dhe justifikon kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit.

Gjykata kreu një shqyrtim të hollësishëm dhe të plotë të të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga debitori dhe caktoi një administrator të përkohshëm. Pas përfundimit të këtij procesi të shqyrtimit, Gjykata argumentoi se debitori ka ndërprerë pagesën e detyrimeve të kredisë, jo sepse ishte në paaftësi paguese, por sepse debitori i kishte kërkuar bankës të zvogëlonte shumën e kredisë për shkak se procesi i shitjes së objektit të ndërtuar nuk po shkonte siç ishte parashikuar. Banka nuk e pranoi këtë kërkesë dhe kërkoi pagesën e kësteve të kredisë sipas planit të kredisë. Meqenëse debitori e ndaloi pagesën e këtyre kësteve, banka filloi ekzekutimin e detyrimeve nëpërmjet zyrës së përmbarimit sipas urdhrave të ekzekutimit të lëshuar nga gjykata.

Në një situatë të tillë, Gjykata vlerësoi se në mënyrë që personat juridikë (siç është debitori në rastin konkret) të konsiderohen si të paaftë për të paguar, duhet të plotësohen dy kushte kryesore^[7]. Kushti i parë lidhet me një situatë financiare në të cilën detyrimet e debitorit janë më të larta se tërësia e pasurive të tij, ndërsa kushti i dytë lidhet me paaftësinë paguese që ekziston në momentin e paraqitjes së kërkesës për falimentim ose që është e parashikueshme në 6 muajt e ardhshëm.

Lidhur me kushtin e parë, Gjykata konstatoi se debitori nuk ishte në gjendje të paaftësisë paguese pasi pasuria e debitorit ishte më e madhe se detyrimet e tij. Ky konstatim erdhi si rezultat i shqyrtimit të pasurisë dhe detyrimeve nga administratori i përkohshëm i caktuar nga Gjykata.

[7] Në bazë të arsytimit të gjykatës, këto kushte duket se konsiderohen si kushte të përbashkëta. Megjithatë, edhe shfaqja e vetëm njëres nga situatat e përmendura në vendim është e mjaftueshme për shpalljen e hapjes së procedurave të falimentimit sipas LF-së.

Për kushtin e dytë, Gjykata, duke iu referuar provave të paraqitura nga administratori i përkohshëm dhe vetë debitori, konstatoi se debitori as nuk është dhe as nuk do të jetë në një të ardhme të afërt në paaftësi paguese. Gjykata gjithashtu vërejti se debitori kishte të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen normale të detyrimeve të tij ndaj palëve të treta, përfshirë bankën. Gjykata vërejti se të ardhurat e debitorit ishin më se të mjaftueshme për të paguar rregullisht këstet e kredisë. Debitori nuk kishte asnjë detyrim për të shlyer plotësisht dhe menjëherë kredinë në bankë, por thjesht ishte i detyruar të rifillonte pagesën e kësteve të kredisë sipas marrëveshjes së kredisë. Një marrëveshje e tillë është rënë dakord edhe nga banka gjatë seancave dëgjimore.

Nga konstatimet e mësipërme dhe diskutimet, Gjykata vendosi të rrëzojë kërkesën e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit.

Çështja nr. 2 – Rrëzimi i pretendimit bazuar në mungesën e kompetencës territoriale të gjykatës së falimentimit

Gjykata	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (Seksioni Tregtar)
Data e vendimit	2 shkurt 2021
Objekti	Hapja e procedurës së falimentimit dhe emërimi i një administratori të përkohshëm falimentimi
Paditësi	Kreditore
Baza ligjore e shqyrtuar nga Gjykata për marrjen e vendimit	Neni 11 i LF-së dhe 15/a i KPC

Përmbledhje e çështjes

Abstrakt

Kreditore i një shoqërie të angazhuar në ofrimin e shërbimeve mjekësore kërkoi hapjen e procedurës së falimentimit për këtë shoqëri pa dhënë asnjë shpjegim se pse shoqëria është në paaftësi paguese dhe pse duhet të hapet procedura e falimentimit. Kërkesa iu dorëzua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndërkohë që debitori i supozuar e kishte selinë në Tiranë.

Të dhënat e procesit

Përpara se të shqyrtojë padinë në themel, bazuar në procedurat standarde gjyqësore, Gjykata fillimisht mori në shqyrtim përcaktimin e kompetencës së saj për të shqyrtuar padinë, duke marrë parasysh se në bazë të nenit 158/a të KPC^[8], kompetenca është

një kusht paraprak i vlefshmërisë së një procesi civil.

Menjëherë u bë e qartë se Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Shkodrës nuk kishte kompetencë territoriale për të shqyrtuar padinë, duke pasur parasysh se vendi i veprimtarisë së debitorit dhe regjistrimi në regjistrin tregtar ishte në Tiranë. Gjykata për këtë konstatim u shpreh se sipas nenit 158/a të KPC-së, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka kompetencë për të shqyrtuar çështjen dhe për rrjedhojë nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural. Gjithashtu, në bazë të nenit 11.1 të LF-së “Kompetenca Territoriale”, Gjykata vërejti se:

Procedura e falimentimit shqyrtohet në gjykatën e falimentimit, ku debitori ka qendrën kryesore të interesit, vendbanimin ose vendqëndrimin kur është person fizik. Gjykata e falimentimit shqyrton me iniciativën e vet nëse ka juridiksion. Duke marrë parasysh se debitori, domethënë shoqëria kundër së cilës është ngritur padia, ka qendrën kryesore të interesit në Tiranë, ndërkohë që nuk ka aktivitet në Shkodër, Gjykata deklaroi se nuk ka kompetencë territoriale për të shqyrtuar çështjen dhe padia duhet të ngrihet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Çështja nr. 3 – Rrëzimi i padisë si rrjedhojë e dorëheqjes së paditësit nga padia^[9]

Gjykata	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Seksioni Tregtar)
Data e Vendimit	28 mars 2018
Objekti	Kërkesë për shpalljen e falimentimit të debitorit
Paditësi	Kreditore
Baza ligjore e shqyrtuar nga Gjykata për marrjen e vendimit	Neni 201 dhe 299/b të KPC-së

Përmbledhje e çështjes

Abstrakt

Kreditore, një shoqëri e njohur ndërtimi në Shqipëri, kërkoi hapjen e procedurave të falimentimit për një tjetër shoqëri ndërtimi. Megjithatë, gjykata asnjëherë nuk e shqyrtoi kërkesën në seancën paraprake (në të cilën paditësi duhej të jepte fakte

palëve u mungon zotësia për të vepruar ose përfaqësimi është në kundërshtim me ligjin, atëherë ai përkatësisht vendos që çështja është jashtë juridiksionit të tyre gjyqësor, i'a kalon çështjen për gjykim gjykatës kompetente, merr vendim në përputhje me dispozitat e këtij Kodi ose u cakton palëve një afat për të korrigjuar aktet e tyre të përfaqësimit.

[9] Në këtë rast ka pasur vetëm një kërkesë nga kreditore dhe ky kreditore nuk është paraqitur para gjykatës, por ka paraqitur një heqje dorë nga çështja.

[8] Në rast se nga studimi paraprak i akteve, gjyqtari konstaton mungesën e juridiksionit ose kompetencës, ose nëse

dhe argumente për kërkesën), pasi paditësi kërkoi rrëzimin vullnetar të kërkesës. Prandaj, nuk është bërë asnjë diskutim për bazat ligjore apo procedurale në lidhje me paraqitjen fillestare të kërkesës për falimentim dhe pse është paraqitur kërkesa.

Të dhënat e procesit

Gjatë seancës së parë, kreditori hoqi dorë nga kërkesa në bazë të nenit 201 të KPC-së, i cili i jep të drejtë kërkuarit të heqë dorë nga kërkesa në çdo kohë, pa qenë nevoja që pala e paditur të bjerë dakord për këtë heqje dore. Gjyqtari vendosi pushimin e çështjes pikërisht për shkak të heqjes dorë të paditësit në seancën paraprake sipas vlerësimeve të mëposhtme:

Paditësi në çdo fazë të procedurës në shkallë të parë mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Heqja dorë do të ketë efekt nëse i padituri e pranon atë. Megjithatë, pranimi i të paditurit nuk kërkohet nëse ai, në momentin kur paditësi paraqet kërkesën për të hequr dorë nga gjykimi, nuk ka depozituar ende prapësimet për themelin e çështjes. Gjykata mund të vendosë pushimin e gjykimit edhe nëse nuk ka arsye legjitime për refuzimin e të paditurit....Neni 299/b i KPC-së përcakton se heqja dorë e paditësit nga padia është një nga shkaqet që i lejon Gjykatës të rrëzojë padinë.

Në këtë rast, Gjykata nuk e ka bazuar vendimin e saj në nenet e LF-së duke qenë se mosparaqitja e paditësit para Gjykatës është një situatë e cila rregullohet vetëm nga KPC.

Kërkesat e tjera të rrëzuara, kryesisht për shkak të mungesës së dokumenteve mbështetëse

Në këto raste, kërkesat janë paraqitur kryesisht nga debitorët, me arsyetimin e pamundësisë për të përmbushur detyrimet e tyre ndaj kreditorëve. Të gjitha këto raste janë pothuajse identike për sa i përket arsyeve të refuzimit të kërkesave nga gjykatat dhe bazës ligjore të refuzimit. Të gjitha çështjet kanë të përbashkët pamundësinë e paditësve për të dorëzuar dokumentet e nevojshme në gjykata. Debitorët nuk kanë mundur t'i paraqesin Gjykatës dokumente që vërtetojnë mjaftueshëm paaftësinë paguese të shoqërive të tyre, kryesisht dokumente të kërkuara nga nenet 14 dhe 17 të LF-së (raportin e debitorit, ku përcaktohen shkaqet e paaftësisë paguese dhe analiza e tij për të ardhmen e biznesit; ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për debitorin; bilancin dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit të aktivitetit të debitorit; listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme; listë të bilanceve aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave; listë të kreditorëve etj.)

Gjykatat e bazuan vendimin e tyre në aspektet thelbësore të LF-së së bashku me rregullat e përgjithshme procedurale të KPC-së shqiptare. Gjykatat vlerësuan se dokumenti i paraqitur i kërkuar nga neni 14/2 i LF-së nuk plotësonte kriteret ligjore të vlefshmërisë. Gjithashtu, Gjykata përdori në shqyrtimin e saj edhe nenin 17 të LF-së, i cili u lejon gjykatave të hapin procedurat e falimentimit kur plotësohen kushtet e përcaktuara në ligj; të refuzojë

kërkesën për mungesë provash; ose t'ia kthejë kërkesën paditësit për plotësimin e të metave në kërkesë. Gjykatat zakonisht vendosin t'i kthejnë kërkesat e paditësve bazuar në arsyet e mëposhtme thelbësore dhe procedurale:

Për sa i përket arsytimit procedural, gjykatat synojnë të mbështeten në një përdorim harmonik të dispozitave të LF-së ashtu edhe të KPC-së dhe argumentojnë se..... *pavarësisht se kërkesa ishte paraqitur në përputhje me LF-në, kjo nuk e pengon gjykatën t'u përmbahet edhe kriterëve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, përveç rasteve kur ligji i posaçëm e parashikon ndryshe. Kodi i Procedurës Civile përcakton qartë se cilat janë parakushtet procedurale për ngritjen e një kërkesëpadie apo padie. Një nga këto parakushte lidhet me interesin legjitim të paraqitjes së padisë, interes të cilin debitori nuk ka mundur ta vërtetojë. Neni 154/a i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: "Kur kërkesëpadia nuk plotëson kushtet e përmendura në këtë kre, (që në këtë rast ishin në përputhje me mungesën e dokumentit mbështetës të parashikuar nga neni 14/2 i LF-së.), gjyqtari i vetëm ia kthen paditësit...." Neni 3 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: "Kërkesa e palëve për fillimin e një procesi gjyqësor është e lidhur me përmbushjen nga ana e tyre të detyrimeve që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara në këtë Kod." Bazuar në sa më sipër, gjykata vlerëson se padia përmban të meta të rënda si nga aspekti material ashtu edhe nga ai procedural dhe i'a kthen paditësit së bashku me provat e paraqitura.*

Neni 14 i LF-së ofron një listë shteruese të dokumenteve të nevojshme për të mbështetur kërkesën e debitorit për të nisur procedurat e falimentimit. Ndërsa kjo listë është relativisht e gjatë, ajo përmban kërkesat bazë që zakonisht kërkohen në legjislacione të ngjashme^[10]. Nga rastet e analizuara, gjykata duket se po shqyrton nga afër dokumentet që mbështesin një kërkesë për fillimin e procedurave të falimentimit, duke përfshirë aspektet e tyre thelbësore. Kjo ka bërë që gjykata të rrëzojë kërkesën e debitorit për të filluar procedurat e falimentimit në disa raste, duke çuar në ndërveprime të shpeshta midis

[10] Lista e dokumenteve të kërkuara nga LF-ja në nenin 14 të saj është si në vijim:

- a) raportin e debitorit, ku përcaktohen shkaqet e paaftësisë paguese dhe analiza e tij për të ardhmen e biznesit;
- b) ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për debitorin;
- c) bilancin dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit të aktivitetit të debitorit. Nëse debitori ka ushtruar veprimtari për një periudhë më të shkurtër kohe, për aq sa është kjo periudhë;
- d) listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë:
 - i. vlerën e çdo pasurie në momentin e blerjes;
 - ii. vlerën aktuale të tregut në rast se këto pasuri kanë qenë objekt i rivlerësimit;
 - iii. vendndodhjen e pasurive; dhe/ose të dhënat e regjistruara në regjistrat publikë nëse këto pasuri janë objekt i ndonjë procedure ligjore; dhe nëse ndonjë nga këto pasuri është vendosur si garanci, ose është objekt i ndonjë barre dhe, nëse po, vlera e kredisë së siguruar;
- e) listë të bilanceve aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave;
- f) listë të kreditorëve, të cilët janë persona fizikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, vlerën dhe burimin e detyrimeve;
- g) listë të kreditorëve që janë persona juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, emrat e përfaqësuesve të tyre ligjorë, nëse është rasti, si dhe vlerat dhe burimin e detyrimeve;
- h) listë të debitorëve të debitorit, qoftë këta persona fizikë ose juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, vlerat dhe burimin e kredisë;
- i) listë të të gjitha procedurave ligjore ku debitori është palë, si paditës ose i paditur.

paditësve dhe gjykatës.^[11] Kërkesa e parë e shoqërisë së debitorit u kthye për mungesë provash materiale në mbështetje të kërkesës për falimentim,^[12] më pas debitori paraqiti një kërkesë tjetër para Gjykatës e cila edhe një herë vendosi t'ia kthejë çështjen paditësit duke marrë parasysh se dokumentet shtesë të paraqitura ende nuk plotësonin kërkesat minimale ligjore të parashikuara me ligj^[13]. Ky debitor ngriti një kërkesë të tretë falimentimi para Gjykatës, e cila pasi pranoi të gjitha dokumentet dhe provat e paraqitura nga shoqëria, vendosi pushimin e çështjes, pasi shoqëria (në cilësinë e debitorit) nuk plotësonte kriteret e parashikuara në Ligjin për Falimentimin për tu shpallur në paaftësi paguese dhe si rrjedhojë e falimentuar pasi shoqëria kishte më shumë pasuri se detyrime.^[14]

Nga ana tjetër, vlen të theksohet se dispozita e nenit 17 të LF-së parashikon vetëm një “shqyrtim të përgjithshëm” të dokumenteve. Në fakt, qëllimi i vetëm i shqyrtimit të këtyre dokumenteve për gjykatën duhet të jetë verifikimi nëse ekziston një formë e justifikuar e paaftësisë paguese të debitorit, siç sugjeron neni 17. Megjithatë, ky studim tregon se gjykata ka hezitur të hapë procedurat e falimentimit me iniciativën e debitorit kur dokumentet ishin të paplota ose mungonin. Dokumentet e renditura në nenin 17 të LF-së janë cilësuar si thelbësore në një Vendim të datës 27.02.2018 ku gjykata ka rrëzuar pretendimin e debitorit me arsyetimin se: “Aktet e paraqitura nuk janë në përputhje me nenin 14/2 të ligjit 110/2016”. Për falimentimin, sipas të cilit dokumentet e nevojshme për hapjen e procedurave të falimentimit sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të jenë origjinale, të nënshkruara dhe/ose të vulosura në çdo faqe dhe të shoqëruara nga një deklaratë, ku shprehet se përmbajtja e dokumenteve shoqëruese është e plotë dhe e saktë. Kushtet formale që duhet të plotësojë kërkesa konsiderohen thelbësore për shqyrtimin e saj nga gjykata.^[15]

Kjo tendencë konfirmohet edhe një herë në rastet e tjera^[16], ku gjykata e ktheu kërkesën e debitorit pavarësisht gjendjes së tij të falimentimit për mungesë dokumentesh.

[11] Vendimi i ndërmjetëm nr. 7398/2307 i shkurtit 2020: gjykata e ktheu kërkesën e debitorit dy herë për mungesë dokumentesh

[12] Vendimi datës 27.02.2018

[13] Vendimi datës 16.10.2018

[14] Vendimi datës 21.03.2019

[15] Ekstrakt nga Vendimi i datës 27.02.2018

[16] Vendimi i ndërmjetëm nr. 7398/2307 i shkurtit 2020

3.3. Çështje me mungesë pasurie

Çështja nr. 1 - Shpallja e falimentimit për shkak të mungesës së pasurive të debitorit për të përmbushur detyrimet e pashlyera ndaj kreditorëve të tij bazuar në nenin 20 të LF-së.

Gjykata	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Seksioni Tregtar)
Data e Vendimit	30 qershor 2021
Objekti	Kërkesë për shpalljen e falimentimit të debitorit
Paditësi	Dy kreditorë
Baza ligjore e shqyrtuar nga Gjykata për marrjen e vendimit	Nenet 2, 15, 16 dhe 20 të LF-së

Përmbledhje e çështjes

Abstrakt

Kreditorët, të dyja shoqëri të njohura të shpërndarjes në Shqipëri, kishin marrëdhënie kontraktuale me debitorin (shoqëri e shitjes me pakicë) për shpërndarjen e produkteve të ndryshme. Për të gjitha produktet e dorëzuara kreditorët kishin lëshuar disa fatura për debitorin, të cilat nuk ishin paguar kurrë. Si pasojë, kreditorët paraqitën dy kërkesa të ndryshme në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale dhe pagesën e të gjitha shumave të pashlyera nga debitori. Gjykata vendosi në favor të kreditorëve dhe e urdhëroi debitorin të shlyente menjëherë detyrimin dhe madje urdhëroi ekzekutimin e vendimit të gjykatës nëpërmjet zyrës së përbarimit në përputhje me procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Megjithatë, as kreditorët dhe as përbaruesit nuk mundën të ekzekutojnë vendimin e gjykatës pasi debitori nuk ka pasur asnjë pasuri apo mjet monetar për të paguar shumat e pashlyera.

Duke marrë parasysh këtë situatë, kreditorët vlerësuan se debitori është i paftë financiarisht të shlyejë detyrimet e tij kontraktuale dhe në këto kushte mund të konsiderohej si në gjendje të paftësisë paguese. Prandaj, “i vetmi mjet i mbetur dhe i disponueshëm për të tërhequr të gjitha ose një pjesë të pagesave të pashlyera nga debitori ishte fillimi i procedurës së falimentimit për këtë të fundit”.^[17]

[17] Deklaratë e nxjerrë nga arsyetimi i gjykatës gjatë marrjes së vendimit për këtë çështje.

Detajet e procesit

Të dy kreditorët iu drejtuan bashkërisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke kërkuar shpalljen e falimentimit të debitorit bazuar në nenin 16 të LF-së, i cili përcakton se: Gjykata e falimentimit duhet të pranojë kërkesën e kreditorit, nëse kreditori provon se debitori është në gjendjen e paaftësisë paguese. Për të paraqitur këtë kërkesë, kreditori duhet të provojë ekzistencën e një detyrimi të maturuar dhe të papaguar. Gjendja e paaftësisë paguese prezumohet në qoftë se kreditori ka dështuar në ekzekutimin e një detyrimi në një procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm gjatë periudhës së ekzekutimit vullnetar, sipas parashikimeve të nenit 517, të Kodit të Procedurës Civile (K.P.C). Debitori, me anë të paraqitjes së provave, mund të kundërshtojë këtë prezumim nëse vërteton se ka aftësi paguese dhe se nuk ka një detyrim të maturuar e të papaguar ndaj kreditorit.

Gjykata vuri në dukje se kreditorët kërkuar hapjen e procedurave të falimentimit dhe pranoi se *prima facie* dukej se debitori është në paaftësi paguese siç vërtetohet nga provat e dokumentuara të paraqitura nga kreditorët, por kjo do të konstatohej përfundimisht nga eksperti. Nga dokumentet e dorëzuara nga kreditorët rezultoi se të dy kreditorët nuk i kanë përmbushur shlyerjet e detyrimeve të debitorëve pavarësisht nga urdhrat e gjykatës të lëshuara në bazë të nenit 517 të KPC-së^[18].

Duke marrë parasysh sa më sipër, përpara se të vendoste nëse do të hapte ose jo procedurën e falimentimit, gjykata, me kërkesën e saj, caktoi një ekspert në përputhje me nenin 19/1, c)^[19] të LF-së, i cili do ta ndihmonte gjykatën të vendoste nëse debitori kishte ndonjë pasuri. Eksperti vuri re se kishte mungesë të informacionit financiar të nevojshëm për të gjykuar pasuritë e debitorit. Kështu, eksperti deklaroi se në mungesë të një informacioni financiar në 3 vitet e fundit (debitori nuk kishte përgatitur asnjë pasqyrë financiare që nga viti 2014), eksperti nuk mund të vlerësonte nëse debitori kishte ndonjë pasuri. Megjithatë, eksperti konstatoi se debitori nuk kishte mjete monetare të depozituara në asnjë llogari bankare. Në deklaratën përfundimtare të ekspertit rezultonte se debitori nuk kishte asnjë pasuri apo mjet

financiar që shërbente si masë falimentimi dhe as mjete monetare për të përballuar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

Bazuar në deklaratat e ekspertit, Gjykata konstatoi se debitori ishte i mbingarkuar me borxh, ndërkohë që pasuritë e tij nuk ishin të vërtetuara siç duhet, kështu që ishte e pamundur të përcaktohej nëse këto pasuri mund të mbulonin apo jo detyrimet ndaj kreditorëve apo kostot e procedurës së falimentimit.

Për sa më sipër, Gjykata vuri në dukje se:

kërkesa e kreditorëve nuk është në përputhje me vetë qëllimin e procedurës së falimentimit, e cila sipas nenit 2 të LF-së synon të shlyejë kolektivisht detyrimet e debitorit përmes likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave. Mungesa e mjeteve për të mbuluar masën e falimentimit dhe kostot e procedurës së falimentimit, e bën pretendimin e kreditorëve të papranueshëm duke iu referuar nenit 20/1 të LF-së. Gjykata shprehet se mungesa e masës së falimentimit çon në rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit. Megjithatë, pikat vijuese të nenit 20 të LF-së^[20] përcaktojnë hapat përkatës ligjorë që duhet të kryhen deri në marrjen e një vendimi përfundimtar për mbylljen e procedurës së falimentimit për shkak të mungesës së pasurisë së debitorit. Në interpretim të kësaj dispozite, gjykata në këtë fazë ka detyrimin ligjor të shterojë të gjitha hapat përkatës dhe të bëjë të gjitha njoftimet e detyrueshme të përcaktuara në të përpara marrjes së vendimit.

Pasi u shteruan të gjithë hapat e përcaktuar në nenin 20 të LF-së, gjykata arriti në përfundimin se megjithëse të gjithë kreditorët ishin të informuar rregullisht, ata nuk

- [20] Neni 20 – Rastet e mungesës së pasurive
1. Në rastet kur masa e falimentimit nuk ka pasuri të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit vendos për përfundimin e procedurës për shkak të mungesës së pasurive.
 2. Përpara se të vendosë përfundimin e procedurës, gjykata e falimentimit informon kreditorët dhe bën shpallje publike të gjendjes në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe në të gjitha autoritetet publike që, sipas rastit, kërkohen nga ligji për të pasqyruar shënimet përkatëse. Kreditorët dhe palët e tjera të interesuara kanë të drejtë që brenda 60 ditëve nga ky njoftim të paraqiten në gjykatën e falimentimit dhe të kundërshtojnë përfundimin e procedurës për shkak të mungesës së pasurive për arsyet e mëposhtme:
 - a) nëse debitori ka pasuri;
 - b) nëse hetimi i mëtejshëm është i nevojshëm në lidhje me pasuritë që debitori ka transferuar dhe që mund të jetë subjekt i veprimit të shmangies, në përputhje me nenin 79 deri 81 të këtij ligji.
 3. Gjykata e falimentimit, brenda 5 ditëve nga mbarimi i afatit të kundërshtimeve, i komunikon prokurorit çdo pretendim të palëve, të cilat kanë arsye të bazuara për nevojën e kryerjes së hetimeve të mëtejshme mbi veprimet e debitorit, dhe pezullon procedurën për 6 muaj për kryerjen e hetimit.
 4. Gjykata e falimentimit vendos përfundimin e procedurës për shkak të mungesës së pasurive nëse:
 - a) nuk ka pasur kundërshtime për përfundimin e procedurës nga palët që mund të kundërshtojnë, pas kalimit të afatit 60-ditor;
 - b) prokurori vendos mosfillimin ose pushimin e çështjes penale;
 - c) kanë kaluar 6 muaj nga komunikimi që gjykata i bën prokurorit për pezullimin e procedurës.

[18] Në fillimin e ekzekutimit të vendimit, Përmbartuesi i lëshon debitorit një njoftim për ekzekutimin vullnetar të vendimit të përfshirë në urdhrin e ekzekutimit, duke caktuar për këtë një afat prej pesë ditësh kur objekti i vendimit lidhet me pagën ose një urdher për mirëmbajtje dhe një afat kohor prej dhjetë ditësh për të gjitha rastet e tjera. Debitori, pasi ka marrë njoftimin për ekzekutim vullnetar, është i detyruar të deklarojë me shkrim gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kreditë që i detyrohen personat e tretë, nëse një gjë e tillë kërkohet nga përmbartuesi gjyqësor. Me kërkesë të debitorit, gjykata e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit, në raste të veçanta, duke marrë parasysh gjendjen financiare të debitorit ose rrethana të tjera të çështjes, dhe pasi të dëgjojë kreditorin, mund të shtyjë afatin e ekzekutimit të detyrimit në para ose mund ta ndajë një detyrim të tillë me këste, përveç rasteve kur ky detyrim lind për shkak të një kredie bankare. Vendimi nxirret në seancë, brenda 20 (njëzet) ditësh nga paraqitja e kërkesës dhe kundër tij mund të bëhet ankim i veçantë. Përmbartuesi gjyqësor kryen shpalljet dhe njoftimet, duke zbatuar dispozitat e Pjesës I, Titulli VI, kreut IV, "Njoftimet" të këtij Kodi.

[19] Nëse njëra nga palët kërkon caktimin e një eksperti ose nëse gjykata e falimentimit e sheh të nevojshme që të ketë një mendim nga eksperti për të vendosur fillimin e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit vendos të caktojë një ekspert ose një administrator falimentimi.

paraqitën asnjë pretendim ose kundërshtim shtesë sipas të drejtave të parashikuara në pikën 2 të nenit 20 të LF-së. Gjykata vlerësoi kështu se mund të vazhdonte me veprimet procedurale të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 20 të LF-së, por në vend të kësaj e rrëzoi kërkesën për shkak të mungesës së pasurive të falimentimit të debitorit.

Në argumentet mbyllëse, gjykata u shpreh se mungesa e masës së falimentimit dhe pamjaftueshmëria e saj për të mbuluar shpenzimet e procedurës, sjell përfundimin e procedurës duke mos pranuar kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit. Për rrjedhojë, gjykata vlerësoi se në bazë të nenit 20 të LF-së, ky pretendim duhet të rrëzohet pikërisht sepse nuk ka pasuri për të mbuluar masën e falimentimit dhe koston e procedurave.

Çështja nr. 2 – Shpallja e falimentimit për shkak të mungesës së pasurive të mjaftueshme për të mbuluar procesin e falimentimit

Gjykata	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (Seksioni Tregtar)
Data e vendimit	28 maj 2019
Objekti	Kërkesë për shpalljen e falimentimit të debitorit
Paditësi	Debitori
Baza ligjore e shqyrtuar nga Gjykata për marrjen e vendimit	Nenet 2, 15, 16 dhe 20 të LF-së

Përmbledhje e çështjes

Abstrakt

Një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në tregun e shërbimeve lokale të transmetimit televiziv u ndikua nga ndryshimet në legjislacion që i detyronin këto lloj shoqëri të zëvendësonin transmetimin analog me platformat e transmetimit digjital. Ky detyrim për të kaluar nga transmetimi analog në atë digjital nuk mund të përballohej financiarisht nga shoqëria për shkak të nivelit të saj me të ardhura të ulëta. Si rrjedhojë, ndryshimet ligjore bënë që shoqëria ta kishte të pamundur të vazhdonte aktivitetin e saj si zakonisht, gjë që rriti nivelin e detyrimeve në krahasim me të ardhurat e saj. Në rrethana të tilla shoqëria nuk kishte mjete të tjera ligjore për të përmbushur detyrimet e pashlyera ndaj kreditorëve të saj dhe kërkoi fillimin e procedurës së falimentimit. Për më tepër, shoqëria deklaroi para gjykatës se nuk mund të paguajë koston e procesit të falimentimit të kërkuar. Në një njoftim për kreditorët, Gjykata i informoi këta të fundit në lidhje me paaftësinë paguese të pretenduar të Shoqërisë dhe gjithashtu theksoi faktin se debitori “nuk ka mundësi të vazhdojë aktivitetin e tij tregtar”.

Detajet e procesit

Gjykata në këtë procedurë e ka bazuar arsyetimin e saj në nenet 14 dhe 17 të LF-së për të verifikuar paaftësinë paguese të debitorit. Në bazë të nenit 17 të LF-së, Gjykata filloi një proces të verifikimit të paaftësisë paguese të dukshme duke kërkuar shqyrtimin e dokumenteve të paraqitura nga debitori (siç kërkohet nga neni 14 i LF-së). Si rrjedhojë, Gjykata kërkoi informacion nga autoritete të ndryshme shtetërore dhe caktoi një administrator të përkohshëm i cili do të ishte përgjegjës për:

- (i) të vlerësuar nëse ka apo jo arsye të besueshme për hapjen e procedurave të falimentimit;
- (ii) të kërkuar dhe shqyrtuar pasuritë e debitorit dhe për të përcaktuar më tej nëse këto pasuri mund të mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit; dhe
- (iii) të dhënë një mendim në lidhje me nevojën e gjykatës për marrjen e masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë së debitorit.

Pas marrjes së të gjithë informacionit të nevojshëm dhe shqyrtimit të pasqyrave financiare të debitorit, administratori i përkohshëm konstatoi se debitori kishte probleme të rënda likuiditeti. Debitori nuk kishte asnjë pasuri të prekshme ose mjaftueshëm para/ekuivalent në para në llogaritë e tij bankare dhe/ose para në dorë, siç tregohet nga pasqyrat financiare për të katër vitet e fundit, dhe veçanërisht për dy vitet e fundit të aktivitetit. Për më tepër, pasqyrat financiare treguan se debitori nuk ka bërë asnjë shpenzim si operativ ashtu edhe kapital në dy vitet e fundit. Për rrjedhojë, eksperti deklaroi para gjykatës se debitori, duke mos pasur nga njëra anë mundësi për të ushtruar veprimtarinë e tij dhe nga ana tjetër, asnjë pasuri apo mjete të tjera monetare për të mbështetur një procedurë falimentimi, nuk ka të drejtë të hapë procesin e falimentimit.

Bazuar në konstatimet e administratorit të përkohshëm, Gjykata vendosi se debitori ishte në kushtet e parashikuara në nenin 20 të LF-së. Përkatësisht, Gjykata pa shpallur ende njoftime publike për të gjithë kreditorët për t'i njoftuar ata për falimentimin e debitorit (sipas pikës 2 të nenit 20 të LF-së) vendosi të rrëzojë kërkesën e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të mungesës së pasurisë së debitorit.

Çështja nr. 3 – Kërkesë e paraqitur në bazë të mungesës së pasurive edhe për të mbështetur një procedurë falimentimi, por procedura në fjalë nuk ishte hapur pasi paditësi nuk kishte dorëzuar dokumentet dhe provat e duhura mbështetëse.

Gjykata	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Seksioni Tregtar)
Data e vendimit	28 mars 2019
Objekti	Kërkesë për shpalljen e falimentimit të debitorit
Paditësi	Debitori
Baza ligjore e shqyrtuar nga Gjykata për marrjen e vendimit	Nenet 13, 17 dhe 20 të LF-së

Përmbledhje e çështjes

Abstrakt

Debitori, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti ofrimin e ndihmës për organizatat publike dhe private duke dhënë me qira pajisje ndërtimi dhe tregtimin e mallrave industriale etj., u ngarkua me borxhe ndaj ortakut të saj të vetëm. Shoqëria në cilësinë e debitorit kërkoi falimentimin sepse nuk ishte në gjendje të përmbushte detyrimet ndaj kreditorit të saj në dukje të vetëm, i cili ishte pikërisht dhe ortak i saj i vetëm. Vlen të theksohet se në momentin e paraqitjes së kërkesës për falimentim, shoqëria kishte qenë në proces likuidimi të nisur nga i njëjti ortak i vetëm disa vite më parë, i cili nuk u përfundua kurrë.

Detajet e procesit

Debitori pretendoi se ishte në kushtet e nenit 20 të LF-së i cili parashikon ngjarje të mungesës së pasurive të mjaftueshme për të mbuluar falimentimin. Për të lehtësuar procesin, ortak i vetëm i debitorit ofroi të mbulonte të paktën shpenzimet e falimentimit.

Megjithatë, debitori nuk ishte në gjendje t'i paraqiste Gjykatës dokumente që vërtetonin mjaftueshëm paaftësinë paguese të shoqërisë, kryesisht dokumente të kërkuara nga nenet 14 dhe 17 të LF-së (raportin e debitorit, i cili përcakton shkaqet e falimentimit dhe analizën e tij për të ardhmen e biznesit; ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit; bilancin dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit të aktivitetit të debitorit; listën e aktiveve të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme; listën e gjendjeve aktuale të parave dhe burimeve të të ardhurave; listën e kreditorëve etj.)

Gjykata e bazoi gjykimin e saj në aspektet thelbësore të LF-së së bashku me rregullat e përgjithshme procedurale të KPC-së shqiptare. Gjykata vlerësoi se dokumentet e paraqitura sipas kërkesave të nenit 14/2 të LF-së nuk plotësonin kriteret ligjore të vlefshmërisë. Në një kontekst të tillë, dokumentet në fjalë, të cilat ishin të nevojshme për hapjen e procedurës së falimentimit, nuk ishin origjinale, nuk ishin të firmosura dhe vulosura në mënyrë të përshtatshme në çdo faqe dhe nuk shoqëroheshin nga një deklaratë që deklaronte se përmbajtja e dokumenteve shoqëruese është e plotë dhe e saktë. Gjithashtu, Gjykata përdori në vendimin e saj edhe dispozitën e përcaktuar në nenin 17 të LF-së, e cila i lejon Gjykatës të hapë procedurat e falimentimit kur plotësohen kushtet e përcaktuara në ligj; të refuzojë kërkesën për mungesë provash; ose t'ia kthejë kërkesën paditësit për plotësimin e të metave në kërkesë. Në këtë rast, Gjykata vendosi t'ia kthejë padinë paditësit pasi nuk kishte kuptim hapja e procedurës së falimentimit, pavarësisht faktit se kreditori i vetëm, i cili ishte edhe ortak i vetëm i debitorit, ofroi të mbulonte shpenzimet e procedurës së falimentimit.

Konkretisht, Gjykata arsyetoi se hapja e procedurave të falimentimit thjesht do të rriste shumën e detyrimeve të Paditësit, pa sjellë asnjë përfitim në proces. Kjo për faktin se është shumë e qartë se kreditori nuk ka pritshmëri për shlyerjen e ndonjë shume të detyrimeve që debitori ka ndaj tij. Ndër të tjera, Gjykata arsyetoi se:

.....Gjykata vëren se debitori paditës nuk ka asnjë interes legjitim për të depozituar këtë kërkesë. Në rast se debitori ka disa kreditorë, ai është në gjendjen e paaftësisë paguese dhe për të mos dëmtuar kreditorët ose palët e treta, ai është i detyruar të kërkojë hapjen e procedurave të falimentimit. Për shkak të këtij detyrimi, ata janë përgjegjës për dëmet që mund të shkaktohen nga palët e treta.... Në këtë rast, shoqëria ka qenë në proces likuidimi të nisur nga ortak i vetëm para disa vitesh dhe gjithashtu, ky ortak ka qenë në dijeni të gjendjes financiare të shoqërisë dhe e ka lejuar atë. Përkundrazi, ortak i vetëm ka krijuar marrëdhënie financiare me shoqërinë duke i dhënë asaj hua për të blerë pasuri të paluajtshme. Pra, është e qartë që mbajtja e një shoqërie që nuk ka aktivitet ekonomik nuk është e arsyeshme sepse mund të dëmtojë palët e treta, por çregjistrimi i shoqërisë mund të mos jetë qëllimi i vetëm i hapjes së procedurës së falimentimit pasi është në kundërshtim me parimet e ligjit të falimentimit. Në këtë kuptim, kërkesa e debitorit për hapjen e procedurave të falimentimit është në kundërshtim me procedurat e falimentimit, që kanë si qëllim shlyerjen kolektive të detyrimeve të debitorit nëpërmjet likuidimit të pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave....

Duke pasur parasysh faktet e dala gjatë seancave gjyqësore, Gjykata konstaton se nuk ka baza të mjaftueshme për të kryer

çregjistrimin e Shoqërisë, bazuar në faktin që pavarësisht se kjo shoqëri nuk ka pasuri të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e procedurave të falimentimit, nga pikëpamja kontabël ajo vazhdon të ketë një kapital të përshtatshëm të regjistruar dhe një depozitë të vogël bankare. Në këto kushte, ortaku i vetëm është i detyruar që fillimisht të zvogëlojë kapitalin e shoqërisë në vlerën reale të tij dhe vetëm pas këtij veprimi juridik mund të kryhet likuidimi i pasurive të Shoqërisë dhe çregjistrimi i saj.

Për sa i përket arsytimit procedural të Vendimit, Gjykata kishte si qëllim të mbështetej në një përdorim të harmonizuar të dispozitave të LF-së ashtu edhe të KPC-së dhe argumentoi se..... pavarësisht se kërkesa është paraqitur në përputhje me LF-në, kjo nuk e pengon Gjykatën që t'u përmbahet edhe kriterëve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, përveç rasteve kur ligji i posaçëm e parashikon ndryshe. Kodi i Procedurës Civile përcakton qartë se cilat janë parakushtet procedurale për depozitim të kërkesëpadiës apo padisë. Një nga këto parakushte lidhet me interesin legjitim të paraqitjes së padisë, interes të cilin debitori nuk ka mundur ta vërtetojë. Neni 154/a i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: "Kur kërkesëpadija nuk plotëson kushtet e përmendura në këtë kre (që në këtë rast ishin në përputhje me mungesën e dokumentit mbështetës të parashikuar nga neni 14/2 i LF-së.), gjyqtari i vetëm i'a kthen atë paditësit..." Neni 3 i Kodit të Procedurës Civile parashikon që: "Kërkesa e palëve për fillimin e një procesi gjyqësor është e lidhur me përmbushjen nga ana e tyre të detyrimeve që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara në këtë Kod". Bazuar nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se padia përmban të meta të rënda si nga aspekti material, ashtu edhe aspekti procedural dhe ia kthen atë paditësit së bashku me provat e paraqitura.

3.4. Çështje e përfunduar me finalizimin e procedurës së falimentimit

E vetmja çështje e falimentimit që është finalizuar në Gjykatë – Shpallja e falimentimit nëpërmjet likuidimit të një shoqërie të basteve sportive

Gjykata	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Seksioni Tregtar)
Data e vendimit	24 qershor 2020
Objekti	Kërkesë për shpalljen e falimentimit për arsye objektive të parashikueshme që debitori nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet brenda afatit për një periudhë prej 6 muajsh ose më pak.
Paditës	Debitori
Baza ligjore e shqyrtuar nga Gjykata për marrjen e vendimit	Nenet 14, 15, 17, 29, 48, 49, 50, 53 dhe 153 të LF-së dhe VKM-ja 733, datë 13.11.2019 "Miratimi i standardeve kombëtare të administrimit të masës së falimentimit" (VKM 733/2019).

Përmbledhja e çështjes

Abstrakt

Debitori, një shoqëri e përfshirë në industrinë e basteve sportive, shpalli falimentimin për shkak të ndryshimeve në legjislacion në lidhje me fushën e saj të veprimtarisë, të cilat bënë të pamundur ushtrimin ligjor të aktivitetit të shoqërisë. Në tetor 2018, parlamenti shqiptar miratoi ligjin për mbylljen e industrisë së basteve sportive dhe aktiviteteve të tjera të lojërave të fatit, të tilla si kazinotë elektronike, si përpjekje për të parandaluar krimin e organizuar. Si një shoqëri që pranonte bastet në aktivitetet sportive, debitori i nënshtrohet qëllimit të ligjit të ri dhe si rrjedhojë aktiviteti i tij u bë "i paligjshëm" dhe si pasojë ky i fundit u kthye në të paafte për të ushtruar aktivitetin dhe për të përmbushur detyrimet ndaj kreditorëve. Në këtë mënyrë, për arsye objektive të parashikueshme, shoqëria deklaroi se nuk mund të shlyejë detyrimet brenda afatit, në një periudhë prej 6 muajsh ose më pak, dhe si rrjedhojë depozitoi në gjykatë kërkesën për falimentim. Me anë të Vendimit të qershorit 2020, pas procesit të falimentimit që u zhvillua brenda një afati të shkurtër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë argumentoi se: Debitori ndalohej të kryej aktivitet tregtar pas miratimit të ligjit 75/2018 i cili kufizon veprimtarinë e lojërave të fatit dhe për rrjedhojë e bën të pamundur kryerjen e aktiviteteve tregtare, pasi qëllimi i biznesit janë lojërat e fatit në ngjarjet sportive. Gjykata më pas shpalli falimentimin e debitorit dhe urdhëroi çregjistrimin e tij nga regjistri tregtar.

Detajet e procesit

Për shkak të pengesave të shkaktuara nga ndryshimet në ligj, debitori nuk mund të

gjeneronte të ardhura të tjera ose të shlyente shumat e papaguara ndaj kreditorëve të tij. Si rrjedhojë, debitori depozitoi një kërkesë për shpalljen e falimentimit sipas neneve 14 dhe 15 të LF-së. Kjo procedurë falimentimi u hap në prill të 2019-s. Në vijim, Gjykata caktoi një administrator falimentimi dhe në zbatim të nenit 29, pika 2 (dh) të LF-së krijoi Komitetin e përkohshëm të Kreditorëve. Pasi vendimi për caktimin e një Komiteti të përkohshëm të Kreditorëve nuk u kundërshtua, në bazë të nenit 50 të LF-së, Gjykata miratoi Komitetin e përhershëm të Kreditorëve të përbërë nga Agjencia e Mbikqyrjes së Lojërave të Fatit, Drejtoria e Tatimeve Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ortaku i debitorit, si dhe punëmarrësi të cilit debitori nuk i kishte shlyer një shumë^[21] të konsiderueshme.

Gjatë procedurës së falimentimit, Administratori i Falimentimit përcaktoi në raportin përkatës të falimentimit edhe shumën e masës së falimentimit dhe detajet e planit^[22] të likuidimit. Komiteti i Kreditorëve (me unanimitet) dhe Gjykata miratuan raportin e Administratorit të Falimentimit. Në vijim, masa e falimentimit iu shpërnda kreditorëve dhe Administratori i Falimentimit deklaroi në gjykatë që Shoqëria nuk kishte pasuri tjetër për të shpërndarë.

Pas shqyrtimit të raportit të administratorit të falimentimit, Gjykata konstatoi se Raporti i administratorit të falimentimit ishte hartuar në përputhje me VKM-në 733/2019 dhe se raporti përmbante gjithashtu masën e shpërblimit, si për administratorin e falimentimit, ashtu edhe për anëtarët e Komitetit të Kreditorëve.

Si rrjedhojë, Gjykata shpalli përfundimin dhe finalizimin e procedurës së falimentimit duke marrë në konsideratë se të gjitha të ardhurat janë shpërndarë tek kreditorët. Ky vendim u bazua gjithashtu në pikën 4 të nenit 153 të LF-së, i cili parashikon që "Në rastin e personave juridikë, kur të gjithë kreditorët shlyhen plotësisht, atëherë shpërndarja e plotë e të ardhurave pas likuidimit të pasurisë sjell prishjen e personit juridik. Në këtë rast, administratori i falimentimit dërgon vendimin e gjykatës së falimentimit në regjistrat përkatës, në mënyrë që të fshijë debitorin nga këta regjistra."

Për arritjen e këtij konkluzioni, gjykata mori parasysh faktin që Komiteti i Kreditorëve kishte rënë dakord unanimisht për kërkesën e administratorit të falimentimit për përfundimin e procedurës. Ky vendim u bazua gjithashtu në Nenet 126, 306 – 310 të Kodit të Procedurës Civile, që rregullon detajet procedurale për zhvillimin e procesit gjyqësor nga fillimi dhe deri në përfundimin e tij nëpërmjet vendimit të gjykatës^[23].

[21] Vendimi i gjykatës nuk përmend numrin e kreditorëve por vetëm kategoritë e tyre. Megjithatë, nga dosja e gjykatës kuptohet që nuk ka pasur pretendime të siguruara dhe kreditorët kryesorë ishin agjenci shtetërore. Të tjerët, ishin ortakët (autorët pretendojnë se ortakët ishin pjesë e kreditorëve sipas huasë që i është dhënë shoqërisë, por vendimi i gjykatës nuk përmban detaje) dhe "kreditorë të tjerë", të cilët sipas autorëve janë punonjës, bazuar në rrethanat e çështjes.

[22] Dosja e gjykatës nuk përmbante prova të dokumentuara dhe si rrjedhojë nuk është përfshirë përbërja e pasurisë, përveç vlerësimit të masës së falimentimit të bërë nga administratori i falimentimit.

[23] Vërehet se në këtë fazë paraprake të zbatimit të LF-së, gjykata ende bazohet në Kodin e Procedurës Civile për

4 Disa reflektime në formën e komenteve të autorëve në lidhje me rastet e studiuara në Pjesën III

Kjo pjesë paraqet disa reflektime të përgjithshme nga Praktika Gjyqësore bazuar në studimin dhe analizën e secilit rast.

Në temën e parë që u trajtua, në çështjen që nuk përfshihej në objektin e zbatimit të LF-së, autorët, pa hyrë në themel të çështjes, konstatuan se gjykata e interpretoi LF-në në lidhje me ligjin e posaçëm për organizatat jo-fitimprurëse i cili rregullon në mënyrë specifike dhe të zgjeruar procedurën e shpërndarjes (përfshirë edhe për shkak të falimentimit). Neni 7.5 i LF-së referon procesin e falimentimit të organizatave në një ligj të posaçëm, nëse ka të tillë, për funksionimin e organizatës përkatëse. Në rastin e përmendur, agjencia publike që do të shpërndahej vepronte si një organizatë publike jofitimprurëse e cila i nënshtrohej parashikimeve të ligjit 8788/2001 për organizatat jofitimprurëse, i cili në kuptim të nenit 7.5 të LF-së konsiderohet si një ligj i posaçëm. Për këtë arsye, Gjykata e pushoi çështjen dhe kërkoi nga Ministria që për shpërndarjen e agjencisë në varësi të saj, të mbështetej në ligjin e posaçëm 8788/2001.

Problematika kryesore në këtë rast lidhej me statusin e Agjencisë dhe kualifikimin e kësaj Agjencie si debitor. LF parashikon që një person fizik ose një person juridik mund të jetë një debitor që i nënshtrohet procedurës së falimentimit. LF-ja përcakton se procedura e falimentimit nuk mund të fillojë ndaj një shteti ose një nga agjencive të tij ose ndaj një njësie të qeverisjes vendore. LF nuk u referohet shprehimisht organizatave jofitimprurëse si debitor të mundshëm, duke i përjashtuar ato nga zbatimi i ligjit. Prandaj, organizata të tilla nuk mund të bëjnë kërkesë për fillimin e procedurave të falimentimit, por i nënshtrohen vetëm një procesi shpërndarje i cili është shumë i ngjashëm me likuidimin.

Në grupin e tretë të rasteve, që kanë të bëjnë me temën e mungesës së pasurisë së debitorit, referuar nenit 20 të LF, autorët konstatojnë se kjo dispozitë sjell konfuzion lidhur me mënyrën si do të adresohen pasojat e përfundimit formal të procedurës së falimentimit për shkak të mungesës së pasurisë. Kjo u tregua qartë në një nga çështjet me mungesë pasurie, ku gjykata, gjatë vendimmarrjes mbi bazën e nenit 20, nuk mundej ta refuzonte apo pranonte kërkesëpadinë, por përdori një terminologji të ndërmjetme (duke deklaruar se kërkesa nuk pranohet dhe prandaj procedura e falimentimit përfundon për shkak të mungesës së pasurisë së debitorit), ndoshta për faktin se neni 20 nuk rregullon pasojat e mbylljes së procedurës së falimentimit. Neni 20, në gjendjen aktuale nuk e përcakton

çështjet në lidhje me falimentimin, edhe pse LF-ja në vetvete është ligj procedural. Në mënyrë të qartë, Gjyqtarët çmojnë se çdo çështje, nga pikëpamja procedurale, duhet të bazohet në Kodin e Procedurës Civile që të konsiderohet e vlefshme, pavarësisht çështjes në fjalë.

qartë se çfarë nënkupton përfundimi i procedurës së falimentimit. Gjithashtu, neni 20 nuk urdhëron në mënyrë eksplicite çregjistrimin e një biznesi pa pasuri për të përmbushur kërkesat e kreditorëve të tij, megjithëse kjo do të ishte një pasojë e natyrshme për një biznes të falimentuar dhe pa pasuri. Reflektimi kryesor këtu është se ndoshta do të ishte e këshillueshme që të bëheshin ndryshimet përkatëse në nenin 20 për të adresuar siç duhet pasojat e përfundimit të çështjes kur nuk ka pasuri për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

Për sa i përket një problematike të përgjithshme procedurale të konstatuar edhe në të kaluarën nga autorët, duket se në këtë fazë paraprake të zbatimit të LF-së, gjykatat mbështeten ende shumë në Kodin e Procedurës Civile për rastet e falimentimit, megjithëse vetë LF është një ligj me karakter procedural. Me sa vihet re, gjyqtarët konsiderojnë se çdo çështje, në aspektin procedural duhet të mbështetet gjithmonë në KPC-në për t'u konsideruar e vlefshme, pavarësisht nga çështja në fjalë. Megjithatë, ky nuk është saktësisht rasti kur zbatohet LF. Ndoshta nevojiten disa përpjekje të tjera për të zbatuar dhe kuptuar mëtej konceptet procedurale të përfshira në LF duke qenë se ato janë të mjaftueshme për të zhvilluar dhe përfunduar procedurat gjyqësore.

SHTOJCA A Statistikat e Çështjeve

Në këtë seksion është paraqitur një shpjegim i shkurtër statistikor i informacionit të dhënë nga 7 Gjykatat e Falimentimit të përzgjedhura në Shqipëri. Nga kërkesat e bëra në gjykatat e përzgjedhura, janë marrë lloje të ndryshme informacioni në lidhje me numrin aktual të çështjeve të depozituara nga debitorët dhe kreditorët bazuar në LF. Informacioni varionte nga të dhënat statistikore që paraqesin rastet aktuale deri te vendimet përfundimtare të shpallura për disa gjykata.

Prandaj u vu re që, pavarësisht se kërkesa ishte posaçërisht për vënien në dispozicion të informacionit të plotë për të gjitha çështjet gjyqësore të falimentimit, të depozituara në bazë të LF-së që nga data e hyrjes në fuqi të tij në vitin 2017, gjykatat si ato të Elbasanit, Korçës dhe Vlorës kanë paraqitur vetëm statistika të papërpunuara të numrit të çështjeve të regjistruara dhe të përfunduara, pa përmendur nëse këto raste i përkasin LF aktual apo ligjit të vjetër të falimentimit.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, më datë 10.01.2022, ka konfirmuar se deri në atë datë nuk ka asnjë procedurë falimentimi në shqyrtim ose të regjistruar në gjykatën e tyre.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, më 28 dhjetor 2021, u përgjigj duke ofruar vetëm të dhëna për çështjet e përfunduara dhe në vazhdim në baza vjetore, të cilat përfshinin informacionin e mëposhtëm: për vitin 2016 kanë përfunduar 10 çështje dhe 1 konsiderohet ende në shqyrtim, në vitin 2017, 4 çështje janë konsideruar të përfunduara dhe 2 në vazhdim, në vitin 2018 nuk është paraqitur asnjë çështje për falimentim, në vitin 2019 është përfunduar vetëm 1 çështje, në vitin 2020 janë përfunduar 2 çështje dhe 1 është ende në shqyrtim për vitin 2021.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, më 29 dhjetor 2021, ka paraqitur një listë me vetëm tre çështje ku 2 kanë përfunduar në vitin 2019 dhe 1 në 2020.

Për statistikat mbi çështjet e falimentimit të dhëna më sipër, për shkak se disponohen vetëm të dhëna statistikore, nuk kishte asnjë mënyrë për të verifikuar nëse ato ishin paraqitur në bazë të LF të ri. Nisur nga informacioni i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ku përfshihen çështjet e depozituara në vitin 2016 kur LF nuk ishte ende në fuqi, mund të konstatohet se statistikat e dhëna nuk janë të gjitha të bazuara në LF-në.

Për sa u përket Gjykatave të Rrethit Gjyqësor Tiranë, Durrës, Fier dhe Shkodër janë vënë në dispozicion për secilën prej këtyre gjykatave vendime përfundimtare të plota të cilat janë klasifikuar si procedura falimentimi. Pas rishikimit të mëtejshëm u vu re se:

- Nga Gjykata Rrethit Gjyqësor Fier janë vënë në dispozicion 18 çështje të shqyrtuara

gjatë viteve 2017-2021, nga të cilat vetëm 2 çështje^[24] janë shqyrtuar pas hyrjes në fuqi të LF-së.

- Nga Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër janë vënë në dispozicion 6 çështje të shqyrtuara gjatë viteve 2017-2021, nga të cilat vetëm 1 çështje është shqyrtuar pas hyrjes në fuqi të LF-së.
- Nga Gjykata Rrethit Gjyqësor Durrës janë vënë në dispozicion 13 çështje të shqyrtuara gjatë viteve 2017-2021, nga të cilat vetëm 3 çështje janë shqyrtuar pas hyrjes në fuqi të LF-së.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dha informacion për 11 çështje të shqyrtuara gjatë viteve 2018-2021, të cilat kanë filluar pas hyrjes në fuqi të LF-së.^[25]

[24] Çështjet për të cilat gjykata ka marrë vendim të formës së prerë p.sh. mungesa e dokumenteve, përfundimi i procedurës së falimentimit, mos hapja e procedurës së falimentimit, etj.

[25] Për sa i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u konfirmua verbalisht se janë edhe 12 çështje në proces të cilat kanë filluar pas hyrjes në fuqi të LF-së.



Projekti zbatohet nga Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), pjesë e Grupit të Bankës Botërore (WBG) dhe me mbështetjen e Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).

Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni:

Z. Igor Matijevic

Menaxher Rajonal për Programin

e-Mail: imatijevic@ifc.org

Znj. Irena Gribizi

Koordinatorë e Projektit për Shqipërinë

e-Mail: igribizi1@ifc.org



Në partneritet me:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO